



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësi: Unit: ZAF	Nr. Prot.: Prot. No.: 149/2024
Jednica: Jednina:	Br. Prot.: Br. Prot.:
Nr. i faqëve: No. of pages: -02-	Data: Date: 24/12/2024
Br. stranic: Br. stranice:	Datum: Datum: Prishtinë

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Nr. i Ref. 149/2024

KOMISIONI PËR VLERËSIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E OFERTAVE, i emëruar sipas Vendimit me nr ref ADM 115/2024 i datës 13 nëntor 2024 i nxjerrë nga U.D. Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së, në përbërje të: Betime Baftiu – Kryetare, Mergime Obërtinca –anëtare dhe Valbona Manaj–anëtare si dhe në mbështetje të Nenit 13, 14 dhe 17 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK, në takimin e datës 20 dhjetor 2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

ANULOHET procedura e prokurimit me nr. 11/24 me titull: Kontratë për ofrimin e shërbimeve të transportit ajror për nevojat e OMK-së, për shkak të mospërbushjes së kushteve siç e parasheh Neni 14 i Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK.

A r s y e t i m

Me datë 13 nëntor 2024, Këshilli Drejtues i OMK-së ka nxjerrë Vendimin me nr ref KD 61/2024 për fillimin e procedurave të prokurimit për përzgjedhje të Kompanisë përgjegjëse që do të kryejë shërbimet e transportit ajror për nevojat e OMK-së. Zyra për Administratë dhe Financa, përkatësisht Zyrtari përgjegjës për prokurim pranë OMK-së, pas përgatitjes së specifikacioneve nga Komisioni përkatës i emëruar nga U.D. Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së, bënë shpalljen publike të njoftimit për tender me nr 11/2024 me datë 3 dhjetor 2024.

Pas përfundimit të afatit ligjor prej 14 (katërmëdhjetë) ditësh për dorëzimin e dosjeve të tenderit, ku vetëm një Operator Ekonomik e ka dorëzuar ofertën, Komisioni për vlerësim dhe përzgjedhje të ofertave në përbërje të tre anëtarëve Betime Baftiu– Kryetare, Mergime Obërtinca –anëtare dhe Valbona Manaj–anëtare, në takimin e mbajtur me datë 20 dhjetor 2024 me fillim në orën 14:30, kanë konstatuar se nuk janë përmbushur kushtet për të vazhduar tutje me procedurën e prokurimit për


shkak se oferta nga Operatori Ekonomik i interesuar sipas njoftimit për kontratë të publikuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, nuk i ka përmbushur kushtet e parapara sipas njoftimit për kontratë siç e parasheh edhe Neni 14 i Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK. Me këtë rast, Komisioni ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet për anulimin e procedurës së prokurimit nr 11/2024 me titull: Kontratë për ofrimin e shërbimeve të transportit ajror për nevojat e OMK-së. Komisioni, poashtu rekomandon që procedura e anuluar e prokurimit të përsëritet jo më larg se 30 (tridhjetë) ditë nga dita kur vendimi me të cilin është anuluar kjo procedurë, është bërë i formës së prerë.

Andaj, në mbështetje të Nenit 13, 14 si dhe Nenit 17 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit të OMK-së, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.


Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të OMK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Komisioni:


Betime Baftiu –Kryetare



Mergime Obërtinca – Anëtare



Valbona Manaj – Anëtare



Prishtinë, 20 dhjetor 2024